



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 190/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterit në shenjën e trafikut në rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

### Arsyetim

Me datën 07.10.2013, subjekti politik LDK, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se me datë 06 tetor 2013 subjekti politik PDK ka vendosur posterin e kandidatit të tyre Agim Aliu, në shenjën e komunikacionit në rrugën „Driton Islami”, në Ferizaj, me të cilin veprim sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje ligjore e nenit 33. pika a), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 3.1.a) të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike dhe nenit 3 të Rr. Zgjedhore Nr.13/2013.

Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 07.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.10.2013 deri në ora 18:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, lidhur me ankesën Anr. 190/2013, të paraqitur nga subjekti politik LDK, ku theksohet se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara lidhur më nenin 33 pika b të LZP\_së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga subjekti politik LDK, pretendohet se anëtarët e subjektit politik të PDK-së, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar Komune Agim Aliu në shenjën e komunikacionit në rrugën „Driton Islami”, në Ferizaj, PZAP-i konstatoi se

pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë ngase dëshmia e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk është dëshmi me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nga fotografia e ofruar si provë nga subjekti politik i LDK-së, nuk mund të identifikohet se a është shenjë e komunikacionit, andaj një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa çart për vërtetimin e pretendimeve ankimore. Prandaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, neni 3.6 pika b), dhe në kuptim të nenit 115.1, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

A nr. 190/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*